

HYZER GASHI

Zëvendësministër i Ministrisë së Financave

Më 09.11.2017 është emëruar Zëvendësministër në Ministrinë e Financave të Republikës së Kosovës.

Ka lindur më 05.05.1960 në fshatin Pjetërshticë, Komuna e Shtimes.

Shkollën fillore e ka kryer në vendlindje, gjimnazin në Lypjan, kurse Fakultetin Ekonomik në Prishtinë në vitin 1984. Ndërsa studimet post diplomike i ka mbaruar në Universitetin e Zagrebit dhe të Prishtinës.

Rrjedh prej një familje me traditë atdhetare, kombëtare që ka edhe dëshmorin e kombit "IDRIZ AJETI".

Në vitin 1984-1998 ka punuar në Komunën e Lypjanit si udhëheqës financiar.

Nga viti 1988-1990 ka punuar në Komunën e Shtimes si drejtor i të hyrave shoqërore dheanëtar i qeverisë komunale, nga ku dhe është larguar me masa të dhunshme nga pushteti serb në vitin 1990.

Është themelues i kompanisë "Besimi Commerce Sh.P.K".

Ka kontribuar në themelimin e "Këshillit Komunal për Financa" në Shtime, ku gjatë vitit 1992, ka pasur postin e nënkryetarit të këshillit. Ka qenë themelues i Sindikatës së zejtarisë.

Ka qenë anëtar i redaksisë së gazetës "Dita" dhe anëtar i forumit të intelektualëve në Shtime.

Gjatë luftës së UÇK-së ka kontribuar në mbështetjen logjistike për furnizim me gjëra ushqimore ku edhe është burgosur me 25.07.1998, nga pushteti serb, si i burgosur politik.

Gjatë demonstratave të vitit 1981 ka qenë pjesëmarrës aktiv, kurse pas luftës së UÇK-së ka marrë pjesë në themelimin e qeverisë së përkohshme në Shtime, e më pas ka kryer edhe detyra në qeverinë e përkohshme të Kosovës përkatësisht në Ministrinë e Financave të Kosovës sidrejtor i tatimeve.

Gjithashtu ka qenë anëtar i Asamblesë komunale të Shtimes në legjislaturën e parë.

Është i martuar me Teutën dhe kanë pesë fëmijë: 3 vajza dhe 2 djem dhe jetojnë në Prishtinë.